



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 43

Prishtinë, më 12.06.2012 në ora 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Petar Miletic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Xhevdet Neziraj

Mungon: Elmi Reçica, Glauk Konjufca, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB-ja Elita Vokshi, Lejla Selimi, përfaqësuesi nga KDI- Nevahir Hazeri, përfaqësuesja nga Ambasada Zvicrane-Sakibe Jashari, dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Kordinatore - Natasa Prica-Tisma, zyrtare e lartë ligjore, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbait të mbledhjeve të kaluara.**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë me raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, me amendamente.**
- 4. Shqyrtimi i realizimit të Planit të punës së komisionit për periudhën e parë kohore 2012.**
- 5. Të ndryshme.**

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara.

Kryesuesi -konstatoi se komisioni njëzëri miratoi procesverbalet e mbledhjeve të datës 18.05.2012, dhe 25.0.2012, pa vërejtje.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë me raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në nr 04/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohen Komisionit Funksional.

Pasi nuk kishte vërejtje Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr.04/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve

II .Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

3. Shqyrtimi i realizimit të Planit të punës së komisionit për periudhën e parë kohore 2012.

Kryesuesi - në fjalën e tij tha si detyrë e fushëveprimtarisë së Komisionit është hartimi i Planit të punës në bazë të zhvillimit të aktivitetet si rezultate të punës

Komisioni i ka zbatuar procedurat e parashikuara me Rregulloren e Punës së Kuvendit, si gjatë shqyrtimit të projektligjeve në parim, po ashtu edhe gjatë hartimit të amendamenteve dhe të përfundimeve. Gjithashtu ka obligim të bëjë rishqyrtimin periodik të realizimit të planit dhe të rezultateve të punës së Komisionit për çerekun e parë të vitit, si dhe realizimi i çështjeve të mbetura të planit.

Ajo që e konsideron mjaft të rëndësishme është se problemet e caktuara, që e përcjellin realizimin e planit, duhet të zgjidhen bashkërisht dhe të ndahen përgjegjësitë.

Në këtë kontekst, mbikëqyrja e implementimit të Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës nga ana e

Komisionit, që bazohet në Planin e veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për integritet evropiane, ka qenë një prej aktiviteteve kryesore për këtë interval kohor.

Në këtë drejtim, Komisioni ka themeluar grupin e punës i udhëhequr nga Elmi Reçica dhe i mbështetur nga personeli për mbështetje dhe nga partneri i OSBE-së *në bazë të të cilëve është përpiluar plani për monitorim dhe plani i veprimit*,

Në kuadër të aktivitetit të mbikëqyrjes së aplikimit të ligjit, grupi i punës ka pasur 6 vizita lokale të vetëqeverisjes në teren (Graçanicë, Ranillug, Prizren, Mamushë, Shtërpçë dhe Kaçanik).

Ky proces është në vazhdim e sipër, ndërsa përpilimi i Raportit final me rekomandime të grupit të punës për mbikëqyrjen e këtij ligji, është planifikuar pas mbajtjes së debatit publik ku gjate muajit qershor do të prezantohet në Kuvend.

Në kuadër të vizitës së Komisionit në terren bashkësive RAE në zonën e Mitrovicës, e kontaminuar me plumb ka mbetur pa u realizuar.

Ky aktivitet do të bartet në çerekun e dytë dhe në bashkëpunim me Komisionin për punë, shëndetësi dhe mbrojtje sociale të kërkohet nga Ministria për Komunitete dhe Kthim raporti për zbatimin e Protokollit për kontrollimin dhe trajtimin nga kontaminimi me plumb dhe gjendjen shëndetësore të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas.

Petar Miletic - pajtohem me të gjitha propozimet e kryesuesit lidhur me Planin e punës por ishe i mendimit se i njëjti raport duhet ti shpërndahet edhe anëtarëve të komisionit, ku krahas vlerësimeve të përgjithshme do të ofrohen edhe sugjerimet tona konkrete.

Në bazë të diskutimeve të paraforësve, kryesuesi muarr qëndrim se kjo pike të shtyhet për mbledhje të rradhës duke udhëzuar personelin mbështetës që raporti i Planit të punës t'ua shpërndahet edhe anëtarëve të komisionit gjë që do të rezultonte me një sukses të përgjithshëm në punën e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic